



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik:“KALLFA”SHPK,

Adresa: TIRANE Njësia Bashkiake nr 5, Rr: Perlat Rexhepi, ND1, H13,16, Zip Code nr 1019

NIPT- J71406006Q

OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: **Nuk ka nënkontraktor**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: **Nuk ka subjekt mbështetës**

* * *

Tipi i Kontratës:Kontratë Shërbimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar/ Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës: **Nr.Ref-32266-12-06-2024**

Referenca e Lotit **Loti II: Nr REF-32275-12-06-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shpenzime printimi dhe mirëmbajtje pajisjesh, (me –lote)”**

Loti II: Shpenzime për printim

Afati i realizimit të shërbimit është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit :**Data: 31.12.2024**

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr.92 datë 31 Dhjetor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “PC STORE” shpk **NIPT-t: L01606034A**

Vlera e ofertës pa TVSH=1,055,000 (një milion e pesëdhjetë e pesëmijë) lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.

2. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF **NIPT-t: L51611004I**

Vlera e ofertës pa TVSH=1,088,000 (nje milion e tetedhjetë e tete) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

3. Operatori ekonomik “IN PRINT” shpk **NIPT-t: L92713601Q**

Vlera e ofertës pa TVSH= 1,181,500 (nje milion e njeqind e tetedhjetë e njemije e peseqind) lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

4. Operatori ekonomik “INSTANT.AL” shpk **NIPT- t:L81506043D**

Vlera e ofertës pa TVSH=1,210,000 (nje milion e dyqind e dhjetemije) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

5. Operatori ekonomik “KALLFA” shpk

NIPT-t: J71406006Q

Vlera e ofertës pa TVSH=1,353,000 (një milion treqind e pesëdhjetë e tremije) lekë pa Tvsh OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

6. Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk

NIPT-t: J62426002Q

Vlera e ofertës pa TVSH=1,433,000 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë) lekë pa Tvsh OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “PC STORE” shpk

NIPT-t: L01606034A

Arsyet e mëposhtme:

- a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 9 Kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 përcaktohet sa më poshtë:*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për pajisjen që posedon dhe do vëre në dispozicion të Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë katalogun/et ose broshurë për këto pajisje. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. (ne te gjitha rastet katalogu duhet i përkthyer në gjuhën shqip).

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik “PC Store” në plotësim të këtij kriteri konstatohet se për pajisjen e kërkuar ne specifikimet teknike “**10 (dhjetë) pajisje me ngjyra-A4**” operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogun apo broshurë i cili të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit sikunder kërkuar.Thënë kjo operatori ekonomik nuk plotëson në tërësi kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.3

b) Për pajisjen e kërkuar në specifikimet teknike “**4 (katër) pajisje –A3 Lazer,bardh/zi**” komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se për këtë pajisje në specifikimet teknike te përcaktuara nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

Dimensioni E x D x H, jo më i madh se:

450x550x700

Operatori ekonomik ka paraqitur ne katalog pajisjen MP 4054 sp me dimension W x D x H: 587X680X963 pra me dimensione më të mëdha se ato të përcaktuara në specifikimet teknike

duke mos plotesuar këtë përcaktim të bërë nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike referuar nevojës së tij.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Sa më sipër përcaktuar pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk konstatohet se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur në spe nga operatori ekonomik. Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me pajisjet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “PC STORE” sh.pk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

2. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF

NIPT-t: L51611004I

Arsyet e mëposhtme:

1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimet teknike” të të procedurës së prokurimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

10 (dhjetë) pajisje me ngjyra-A4 me këto specifikime teknike:

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtësia:	30 - 40faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6 -10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H, jo më i madh se:	500x570x510
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 250faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më i vogël 200faqe
Madhësia e letrës	A4
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po

Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar katalogun ku në plotësim të kësaj pajisje ka paraqitur pajisjen RICOH MPC 307 me dimension W X D X H: 498X585X510. Nga verifikimi i perputhshmerise me specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk ploteson parametrin (D) i cili eshte me i madh se maksimumi i kerkuar.

2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimet teknike” të të procedurës së prokurimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

4 (katër) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H, jo më i madh se:	450x550x700
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues

Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar katalogun ku në plotësim të kësaj paisje ka paraqitur paisjen paisjen RICOH MP 4054 me dimension WDXH: 587 X 680 X 963. Nga verifikimi i perputhshmerise me specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk ploteson parametrat (W X D X H) të cilat janë me të mëdhenj se maksimumi i kerkuar.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Sa më sipër përcaktuar pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF konstatohet se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur në spe nga operatori ekonomik. Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF nuk

plotëson specifikimet teknike në lidhje me paisjet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” PF nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret dhe specifikimet e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

3. Operatori ekonomik “IN PRINT” shpk

NIPT-t: L92713601Q

Arsyet e mëposhtme:

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82 pika 4 u bë përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët.

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

Fondi limit i Lotit të dyte: 1.600.333,33

25% X1.600.333,33=400.083,33

1.600.333,33-400.083,33 =1.200.249,99

Pra cdo oferte që rezulton nën këtë vlerë konsiderohet oferte anomalisht e ulët.

Oferta e operatorit ekonomik “InPrint” shpk është në vlerën 1.181.500 pra nën vlerën 1.200.249,99 dhe për rrjedhojë vlerësohet si ofertë anomalisht e ulët pra nuk është ofertë e rregullt.

Mqse jemi në kushtet e procedurës së prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar komisioni i vlerësimit të ofertave e refuzon këtë ofertë, duke e skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

4. Operatori ekonomik “INSTANT.AL” shpk

NIPT- t: L81506043D

Arsyet e mëposhtme:

1. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik, pika 2.3.1 percaktohet sa më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 320 066,66 (treqind e njëzetmijë e gjashtëdhjetëe gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa Tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” konstatohet se në plotësim të këtij kriteri ka paraqitur fatura nga Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike e cila është institucion shtetëror. Për institucionet shtetërore është kërkuar që si dokumentacion provues të paraqitet kontrata e lidhur me institucionin dhe vërtetimi për realizimin me sukses të kontratës dokumentacion i cili nuk është paraqitur nga operatori ekonomik duke mos plotësuar kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.1.

2. Në dokumentat e tenderit shtojca 9 Kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 percaktohet sa më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për pajisjen që posedon dhe do vërë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor, duhet të paraqesë katalogun/et ose broshurë për këto pajisje. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. (në të gjitha rastet katalogu duhet i përkthyer në gjuhën shqip).

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” në plotësim të këtij kriteri konstatohet se për pajisjen e kërkuar në specifikimet teknike “**10 (dhjetë) pajisje me ngjyra-A4**” operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogun apo broshurë i cili të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit sikunder kërkuar.

Gjithashtu konstatohet se per pajisjen e kërkuar në specifikimet teknike **2 (dy) pajisje –A3 Lazer/me ngjyra** operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogun apo broshure i cili të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit sikunder kerkuar.Thene kjo operatori ekonomik nuk plotëson në tërësi kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.3 pasi për dy nga pajisjet e kërkuara nuk ka paraqitur katalog apo broshure.

3.Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimet teknike” të të procedurës së prokurimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

4 (katër) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni E x D x H, jo më i madh se:	450x550x700
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për

	ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “INSTANT.AL” shpk në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar katalogun ku në plotësim të kësaj paisje ka paraqitur paisjet pajisjet CANON imageRUNNER 2900 dhe CANON imageRUNNER Advance DX 6800. Pajisja CANON imageRUNNER 2900 ka dimension WDXH: 565x659x788. Pajisja CANON imageRUNNER Advance DX 6800 e ka dimensionin W x D x H : 620x722x937. Nga verifikimi i perputhshmerise me specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk ploteson parametrat (W X D X H) të cilat në të dyja pajisjet e paraqitura janë me të mëdha se maksimumi i kërkuar.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Sa më sipër përcaktuar pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Instant.AL” shpk konstatohet se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur në spe nga operatori ekonomik. Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik “INSTANT.AL” shpk nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me pajisjet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të

ofertave konkludon se operatori ekonomik “Instant.al” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret dhe specifikimet e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

5. Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk

NIPT-t: J62426002Q

Arsyet e mëposhtme:

1.Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” të procedurës së prokurimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

4 (katër) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
<u>Resolucioni</u>	<u>1200x1200 dpi</u>
Dimensioni W x D x H, jo më i madh se:	450x550x700
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB
Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues

<u>Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershëm të dy anëve të letrës)</u>	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing (aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “InfoSoft Office” sha në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar katalogun ku në plotësim të kësaj paisje ka paraqitur paisjen RICOH MP 350. Pajisja RICOH MP 350 e ka rezolucionin e printimit **600 x 600 dpi**. Nga verifikimi i perputhshmerise me specifikimet teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik nuk plotëson rezolucionin e printimit të kërkuar në specifikimet teknike **1200x1200 dpi**.

Gjithashtuu për këtë pajisje është kërkuar skanimi: SPDF Single pas document feeder (skanim i njehershëm i të dy anëve të letrës).

Pajisja RICOH MP 305 skanimin e ka ne versionin ARDF (automatic reverse document feeder). Pra sa më siper nuk plotëson specifikimet teknike përcaktuar nga autoriteti kontraktor per kete pajisje.

2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimet teknike” të të procedurës së prokurimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike përcaktohet si më poshtë:

4. 2 (dy) pajisje –A3 me këto specifikime teknike

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Me ngjyra
Shpejtësia:	30-40 faqe/min
Ekrani jo më i vogël se:	6-10.1 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H, jo më i madh se:	590x685x965
Kapaciteti mbajtës i sirtareve	Jo më i vogël 500faqe
Kapaciteti në dalje	Jo më e vogël 250faqe
Madhësia e letrës	A6-A3
Memorja jo më e vogël:	2 GB
HDD - Hardisk jo më i vogël	250-320 GB

Aplikacione	Pajisja duhet të mundësoj instalimin e aplikacioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe aplikacion për monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundësi skanimi në HDD	Pajisja duhet të mundësoj skanimin në HDD e saj dhe krijimin e folderave të ndryshëm për secilin përdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njëhershëm të dy anëve të letrës)	Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB)
Kapaciteti i SPDF/DADF (me e madhe baraz)	50 faqe
Mobile printing(aftësi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet të mundësoj encryptimin të hardiskut për ruajtjen e informacionit të printim/skanim/fotokopjim.
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po
Pajisja të mundësoj skanimin e dokumentave direkt në Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “InfoSoft Office” sha në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar katalogun ku në plotësim të kësaj paisje të kërkuar ka paraqitur paisjen RICOH IM 370.Pajisja RICOH IM 370 është pajisje bardh e zi duke mos plotësuar specifikimet teknike ku pajisja është kërkuar me ngjyra. Pra sa më sipër nuk plotëson specifikimet teknike përcaktuar nga autoriteti kontraktor për këtë pajisje.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë

përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Sa më sipër përcaktuar pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sha konstatohet se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur në spe nga operatori ekonomik. Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik “Infosoft Office” sha nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me paisjet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.a nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**KALLFA**”SHPK, me adresë: TIRANE Njësia Bashkiake nr 5, Rr: Perlat Rexhepi, ND1, H13,16, Zip Code nr 1019 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,353,000 (një milion treqind e pesëdhjetë e tremije) lekë pa Tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni pranë :Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga“Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë,brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *nuk eshte rasti* siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

